



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2019:280838  
Datë: 09.12.2022  
Numri i dokumentit: 03736463

**A.nr. 2302/2019**

**GJYKATA THEMELORE PRISHTINË**, Departamenti për Çështje Administrative, me gjyqtaren Lirije Maksutaj, zyrtaren ligjore Kaltrina Çitaku, në konfliktin administrativ të paditëses, Gj.. H..me vendbanim në V.., kundër të paditurës, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale - Departamenti i Pensioneve, Prishtinë, me bazë anulimin e aktit kontestues, në mungesë të palëve ndërgjyqëse, në seancën e shqyrtimit kryesor dhe publik, më 07.11.2022, merr këtë:

**A K T G J Y K I M**

**Refuzohet** kërkesëpadia e paditëses, Gj.. H.., me të cilën ka kërkuar që të anulohet vendimi i të paditurës, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale - Departamenti i Pensioneve me numër të dosjes 6019093, i datës 27.06.2019, **si e pabazuar**.

**A r s y e t i m**

Seanca e shqyrtimi kryesor është mbajtur në kuptim të nenit 41 të LKA-së, pa praninë e palëve ndërgjyqëse, të ftuar në mënyrë të rregullt nga gjykata.

Paditësja, në padinë e parashtruar në këtë gjykatë më 30.09.2019, ka shpjeguar se e refuzon vendimin e të paditurës pasi që ky vendim është njxerrë duke bërë shkelje thelbësore të dispozitave të Ligjit Nr. 02/L-28, për Procedurën e Përgjithshme Administrative, konkretisht neni 84 par. 2 dhe 85 sepse vendimi i goditur i të paditurës nuk përmban arsyetim të formuluar qartë dhe nuk janë dhënë arsyet mbi faktet vendimtare që kanë kushtëzuar marrjen e vendimit të kundërshtuar, ngase në arsyetimin e vendimit është dhënë një formulim i përgjithshëm dhe abstrakt duke mos i precizuar arsyet lidhur me refuzimin e ankesës së palës paditëse. Sipas saj, nuk janë aplikuar drejt dispozitat e Ligjit për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti, bazuar në nenin 9 par. 5, pasi që e paditura nuk ka saqaruar saktë se cili nga kriteret nuk është plotësuar, meqë janë 4 (katër) kriteret që duhet të përmbushen. Ka shtuar se paditësja duhet ta realizoj këtë të drejtë ngase gjendja e saj shëndetësore është shumë e rëndë, e papërmirësueshme duke e bërë atë të paaftë për punë. Poashtu paditësja nuk është e aftë të kryej punë të dobishme për familjen dhe rregullisht dikush nga anëtarët e familjes duhet të përkujdeset për të për shkak të gjendjes së rëndë shëndetësore. Gjithashtu familja ka shpenzime të mëdha lidhur me trajtimin e sëmundjeve, realizimin e kontrolleve mjekësore si dhe furnizimit me barna, andaj është shumë e nevojshme që paditësja ta realizojë pensionin e parakohëshëm. Andaj, i ka propozuar gjykatës, që pas

administrimit të provave ta aprovojë kërkesëpadinë e paditëses dhe ta anulojë vendimin e të paditurës.

Përfaqësuesja e të paditurës, në përgjigjen në padi me shkrim të dhënë pranë kësaj gjykate, më 02.12.2021, e ka kontestuar në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditëses si të pabazuar. Sipas palës së paditur, Komisioni ekspert mjekësor ka konstatuar se paditësja nuk ka dëshmi të mjaftueshme për të qenë shfrytëzuese e pensionit me aftësi të kufizuar të plotë dhe të përhershme dhe me këtë rast ka refuzuar ankesën e paditëses si të pabazuar. Ka kërkuar nga gjykata që të refuzoj kërkesëpadinë e paditëses si të pabazuar dhe ta lë në fuqi Vendimin nr. i dosjes 6019093 të dt. 27.06.2019.

Gjykata në seancën e shqyrtimit kryesor më 07.11.2022, ka bërë administrimin e provave dhe atë: vendimi i dt. 27.06.2019, raporti konziliar 31.03.2016, raporte nga konsulta të dt. 03.12.2018, dt. 20.11.2017, vendimi i dt. 17.04.2019, kërkesa për pension për persona me aftësi të kufizuar e dt. 30.01.2019, raporti specialistik i dt. 08.11.2016, fletëshimi dhe data e pranimit e dt. 21.01.2016-03.03.2016, vlerësimi i komisionit mjekësor/konstatimi i tij i dt. 16.04.2019, shqyrtimi i ankesave i dt. 05.06.2019, certifikata e mjekut e dt. 10.12.2018.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit të goditur me padi në përputhje me nenin 44 të Ligjit për Konfliktet Administrative dhe provave të administruara në seancën e shqyrtimit kryesor, ku ka gjetur se kërkesëpadia e paditëses është e pabazuar.

Me vendimin e të paditurës, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale – Departamenti i Pensioneve, me numër të dosjes 6019093, i dt. 27.06.2019, është refuzuar si e pabazuar ankesa e paditëses për njohjen e të drejtës në pension të personave me paaftësi të përhershme.

I pakënaqur me këtë vendimin e MPMS-së, paditësja ka ushtruar padi në këtë gjykatë më 30.09.2019, duke e kontestuar ligjshmërinë e të njëjtit.

Gjykata, për të vlerësuar ligjshmërinë e vendimit të kontestuar me padi, i'u referua Ligjit nr.04/L-131 për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti, përkatësisht nenit 9, paragrafit 1 dhe 5 të njëjtit, ku parashihet që "Pensioni i paaftësisë të përhershme do t'iu ofrojë mbështetje financiare personave të përzgjedhur në përputhje me kriteret e përcaktuara me këtë ligj, sipas mjeteve të ndara për këtë qëllim nga Buxheti i Republikës së Kosovës. Një person do të konsiderohet me paaftësi të përhershme, nëse: ofron dëshmi se është me paaftësi të përhershme para se të aplikojë për pension, duke siguruar të gjitha dëshmitë mjekësore; Komisioni Mjekësor vlerëson se ekziston paaftësia e përhershme e punës të parashtruesi i kërkesës; Komisioni Mjekësor vlerëson paaftësinë në kohëzgjatje për periudhën prej një (1), tre (3) apo pesë (5) vitesh; Pas skadimit të afateve të përcaktuara në nenin paragrafin 5.3 të këtij paragrafi personi i nënshtrohet procedurës së rivlerësimit mjekësor."

Gjykata pasi ka administruar provat dhe vlerësuar të njëjtat një nga një e së bashku gjegjësisht vendimi i dt. 27.06.2019, raporti konziliar 31.03.2016, raporte nga konsulta të dt. 03.12.2018, dt. 20.11.2017, vendimi i dt. 17.04.2019, kërkesa për pension për persona me aftësi të kufizuar e dt. 30.01.2019, raporti specialistik i dt. 08.11.2016, fletëshimi dhe data e pranimit e dt. 21.01.2016-03.03.2016, vlerësimi i komisionit mjekësor/konstatimi i tij i dt. 16.04.2019, shqyrtimi i ankesave i dt. 05.06.2019, certifikata e mjekut e dt. 10.12.2018, gjykata ia ka falur besimin arsyetimit të paditurës se paditësja nuk ka ofruar dëshmi të mjaftueshme me prova dhe fakte, përkatësisht raporte mjekësore me të cilat do të dëshmonte se është person me paaftësi të përhershme, as para organeve administrative por dhe para kësaj gjykate.

Kjo gjykatë për çështjen e paditëses iu referua vendimeve që janë të aplikueshme në bazë të nenit 53 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës *“Të drejtat njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut”*.

Në bazë të Gjykatës Evropiane të drejtave të Njeriut - lidhur me nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, *“E drejta për një gjykim të drejtë”*. Kur i vetmi mendim ekspertësh i prodhuar para gjykatës është lëshuar nga një organ i specializuar, për shembull në lidhje me përfitimet e aftësisë së kufizuar, ai do të ketë një ndikim vendimtar në gjykatë në mungesë të një mendimi të dytë nga një ekspert i pavarur (Devinar kundër Sllovenisë, -49-50). Konventa nuk i ndalon gjykatat kombëtare të mbështeten në mendimet e ekspertëve të hartuara nga organet e specializuara që janë vetë palë në rastin kur kjo kërkohet nga natyra e çështjet në diskutim (Letinčić v Kroacisë., 61; Devinar kundër Sllovenisë, § 47).

Fakti që një ekspert është i punësuar nga i njëjti autoritet administrativ që është palë në çështje mund të shkaktojë dyshime pjesa e kërkuarit si palë kundërshtare, por ajo që është vendimtare është nëse dyshime të tilla mund të jenë konsiderohet i justifikuar objektivisht (Devinar kundër Sllovenisë, §§ 48 dhe 51). Kur kërkon një mendim të dytë nga një ekspert i pavarur, kërkuarit i kërkohet të prodhojë material të mjaftueshëm për të vërtetuar kërkesa (po aty, §§ 56-58). Nëse aplikanti nuk e bën këtë, megjithëse kishte të drejtë për të komentuar mendimin e ekspertit dhe sfidon atë me shkrim dhe me gojë ose të paraqisni një mendim të kundërt nga një specialist i zgjedhur prej tij ose i saj.

Andaj, mbi bazën e këtyre rrethanave, paditësja nuk ka parashtruar ndonjë propozim për ndonjë ekspertizë të re, sipas vlerësimit të gjykatës, e njejtja ia ka falur besimin ekspertëve para organeve administrative se këtu paditësja si ka plotësuar kushtet për realizimin e të drejtës për pensionin e personave me paaftësi të përhershme konform dispozitave të lartëcituara të Ligjit nr.04/L-131 për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti respektivisht nenit 9 paragrafit 5 të tij.

Kjo gjykatë ka vlerësuar dhe pretendimet e paditëses se ka përmbushur kriteret e ligjit për t'i njohur të drejtën në këtë lloj pensioni dhe se e njejtja ka ofruar dëshmi të mjaftueshme para komisioneve mjekësore, por si të tilla këto pretendime nuk ishin me ndikim në një vendosje tjetër nga çfarë është vendosur nga e paditura bazuar në vlerësimet e Komisioneve Mjekësore të autorizuara me ligj. Pra kjo gjykatë, këto pretendime nuk ka gjetur bazë për t'i aprovuar pasi e paditura ka zhvilluar drejt procedurën dhe ka zbatuar ligjin respektivisht kriteret e përcaktuara të cilat duhet të plotësohen në kuptim të Ligjit nr.04/L-131 për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti, përkatësisht nenit 9, paragrafit 1 dhe 5 të tij.

Në këtë kuptim, gjykata vlerëson se vendimi kontestues, është i drejtë dhe i bazuar në ligj dhe se organi i paditur, drejtë ka zbatuar dispozitat e LPPA-së, drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike dhe zbatuar ligjin material, kur ka refuzuar ankesën e paditësit bazuar në vlerësimin e Komisionit Mjekësor të Shkallës së Dytë dt. 05.06.2019.

Mbi këto arsye, kërkesëpadinë e paditëses nuk e aprovoi, sepse sipas vlerësimit të Gjykatës, nuk është cënuar ligji material në dëm të saj.

Duke u bazuar në arsyet e dhëna me lart, gjykata në kuptim të nenit 43, 46.2, lidhur me nenet 5, 6 dhe 38 të Ligjit për Konfliktet Administrative, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE PRISHTINË**  
Departamenti për Çështje Administrative

A. nr. 2302/2019, më 07.11.2022

Zyrtare Ligjore  
Kaltrina Çitaku

Gj y q t a r j a  
Lirije Maksutaj

**Këshillë Juridike:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.